



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Project Ahead

Societá cooperativa



Mjedisi Mundësues për Aktivitetin Filantropik në Shqipëri

Prill 2020

© 2019 nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ky publikim u përgatit në kuadër të projektit **“EMBRACE” - Modele Sipërmarrjeje që Ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese** me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Autorët:

**Juliana Hoxha
Eriha Haska**

PARATHËNIE

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Partnerët Shqipëri), si një organizatë që punon në këtë fushë prej një dekadë tanimë, beson se filantropia është një faktor i rëndësishëm në zhvillimin dhe përmirësimin e shoqërisë në përgjithësi. Partnerët Shqipëri punon për zhvillimin e filantropisë në disa dimensione duke promovuar kulturën e dhurimit në Shqipëri, duke hulumtuar për të kuptuar më mirë karakteristikat e këtij aktiviteti, potencialin, sfidat me qëllim advokimin për një mjedis mundësues në këtë drejtim.

Për të rritur ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut mbi rëndësinë e aktivitetit filantropik, Partnerët Shqipëri organizon një aktivitet vjetor “Çmimi i Filantropisë” kushtuar kontributit më të madh filantropik të dhënë nga individë dhe kompani. Ky aktivitet është i kombinuar me monitorimin sistematik të aktivitetit filantropik në Shqipëri, të aksesueshme për publikun në formën e raporteve sasiore dhe cilësore mujore dhe vjetore (2015, 2016, 2017, 2018). [🔗](#)

Partnerët Shqipëri ka hedhur themelet e para në hulumtimin e fushës së filantropisë në Shqipëri. Për të hedhur pak dritë mbi rrënjët e filantropisë, Partnerët Shqipëri publikoi studimin *Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri* [🔗](#), i cili paraqet zhvillimin e veprimtarisë filantropike në Shqipëri në periudha të ndryshme historike, duke filluar nga shekulli XIX.

Në vitin 2011, Partnerët Shqipëri publikoi studimin *Sipërmarrja dhe Filantropia* [🔗](#), duke synuar të investigojë dhe analizojë shkallën dhe natyrën e aktivitetit filantropik të realizuar nga komuniteti i biznesit në Shqipëri. Në 2017, Partnerët Shqipëri publikoi studimin e dytë mbi *Aktivitetin Filantropik të Ndërmarrjeve në Shqipëri* [🔗](#) për të vlerësuar nivelin e aktivitetit filantropik të realizuar nga sektori i biznesit në Shqipëri, tiparet dhe trendet e zhvillimit të tij gjatë harkut kohor 2011 - 2016.

Tabela e Përmbajtjes

05	Terminologjia
06	Hyrje
07	1. Situata e Sektorit Filantropik në Shqipëri
08	2. Kuadri Tatimor dhe Fiskal
08	2.1. Sistemi Tatimor Mundësues për Marrjen dhe Dhënien e Dhurimeve në Shqipëri
08	2.1.1. Marrja e Dhurimeve nga Organizatat Filantropike
08	2.1.2. Dhurimi nga Biznesi
09	2.1.3. Dhurimi nga Individët
09	2.2. Sistem Tatimor Mundësues për Dhurimet - Praktikat më të mira Ndërkombëtare
09	2.2.1. Marrja e Dhurimeve nga Organizatat Filantropike
10	2.2.2. Dhurimi nga Biznesi
10	2.2.3. Dhurimi nga Individët
11	3. Aktiviteti Filantropik Ndërkufitar
11	3.1. Mjedisi Rregullator për dërgimin dhe marrjen e dhurimeve ndërkufitare në Shqipëri
11	3.2. Mjedisi rregullator për dërgimin dhe marrjen e dhurimeve ndërkufitare - Praktikat më të mira ndërkombëtare
12	4. Mjedisi politik
12	4.1. Praktika shqiptare
12	4.2. Praktikat më të mira ndërkombëtare
13	5. Trendet Globale në Sektorin Filantropik
15	6. Rekomandimet Kryesore për Përmirësimin e Mjedisit Filantropik
16	Referenca

TERMINOLOGJIA

Filantropia Korporative - “dhurime fondesh, kohe, burimesh dhe shërbimesh në natyrë nga kompanitë për iniciativa bamirëse, jofitimprurëse dhe/ose iniciativa komunitare me qëllim “investimin e një pjese të fitimit për të mirën e përbashkët”.[1] Filantropia korporative konsiderohet si një lloj specifik i Përgjegjësisë Sociale të Biznesit (PSB). Ka korporata që krijojnë fondacione ose përfshijnë praktikën e PSB në punën e tyre. Filantropia korporative po bëhet një forcë kryesore, si përmes njësive të PSB-së ashtu edhe fondacioneve të pavarura të korporatave (Liang & Renneboog, 2016).

Përgjegjësia Sociale e Biznesit - PSB ka të bëjë me “biznese që kanë përgjegjësi dhe ndërmarrin veprime përtej detyrimeve të tyre ligjore dhe qëllimit ekonomik” (European Commission, 2002). PSB nuk merret vetëm me filantropinë korporative, por edhe me çështje të tjera që prekin mjedisin, konsumatorët, të drejtat e njeriut, qëndrueshmërinë e zinxhirit të furnizimit dhe transparencën për të mirën e përbashkët në tërësi.

Fondacionet e korporatave janë “organizata filantropike që krijohen dhe mbështeten financiarisht nga një korporatë. Fondacioni është krijuar si një entitet juridik i veçantë nga korporata, por me lidhje të ngushta me korporatën” (Council on Foundations).

Liria filantropike i referohet “ekzistencës së kushteve dhe elementeve mundësues që janë të pranishëm në një shoqëri për të mbështetur aktivitete filantropike të lira, të pavarura dhe të qëndrueshme” (Lilly Family School of Philanthropy, 2018).

Organizata Filantropike - OF i referohet “një forme të organizatave joqeveritare, joshtetërore që ofrojnë shërbime për të mirën publike”. Përfshihen si vijon: fondacionet (grantmarrëse, operative, nga korporatat, komunitare, ose të sponsorizuara/krijuara nga qeveria), organizatat me bazë komunitare dhe shoqatat në fshatra, shoqatat profesionale, grupet e mjedisit, grupet e avokimit, kooperativat, organizatat bamirëse, qendrat, organizatat fetare, shoqëritë e bashkëpunimit, sindikatat e punës, shoqëritë, institutet kërkimore, organizatat e diasporës, portalet online me qëllime sociale dhe koalicionet ndërkombëtare dhe ndërsektoriale” (Lilly Family School of Philanthropy, 2018).

[1] Website i The Corporate Social Responsibility Newswire. Url: <https://www.csrwire.com/>

HYRJE

Ekziston besimi se filantropia institucionale mund të stimulojë investimet strategjike dhe ka një ndikim në rritje në zgjidhjen e çështjeve ekonomike dhe sociale. Duke qenë se shumë vende dhe kultura kanë një traditë të gjatë filantropike, sektori global i fondacioneve po rritet veçanërisht në vendet me të ardhura të larta (Johnson, 2018).

Shtetet e Bashkuara konsiderohen si vendi më bujar në botë gjatë dekadës së kaluar me 95% të donatorëve që kanë dhuruar 224 miliardë Euro në total, sipas Indeksit Botëror të Dhurimit (Charities Aid Foundation, 2019). Në krahasim me Shtetet e Bashkuara, Evropa renditet mjaft ulët me 44% të donatorëve që kanë dhuruar 22,4 miliardë Euro (Observatoire de la Fondation de France, 2015).

Sidoqoftë, në shumë vende në të gjithë Evropën filantropia po rritet si një burim financimi në veçanti duke adresuar inovacionin social. Para shumë shekujsh, filantropët ishin financuesit kryesorë të institucioneve sociale, kulturore dhe fetare. Në ditët e sotme, tradita e pasur e dhurimit është në rritje në Evropë (European Research Network on Philanthropy, 2017). Ekziston një përparim i filantropisë joformale dhe institucionale, e shfaqur në nivele të ndryshme në të gjithë Evropën (Lilly Family School of Philanthropy, 2018). Sidoqoftë, faktet mbi volumin dhe impaktin social mungojnë.[2]

Pavarësisht mungesës së të dhënave të besueshme dhe publike, aktiviteti filantropik dhe fillesat e metodave inovative filantropike po zhvillohen edhe në Shqipëri. Ky punim synon të paraqesë një përmbledhje të situatës filantropike në Shqipëri dhe të pasqyrojë tendencat kryesore dhe praktikatat më të mira nga vendet e tjera, të cilat mund të shërbejnë për një kuptim më të mirë të dinamikës nga grupet e interesit, pjesë të sektorit të organizatave filantropike (OF). Punimi është i strukturuar bazuar në disa nga treguesit kryesorë që përbëjnë lirinë filantropike si çështjet tatimore dhe fiskale, aktiviteti filantropik ndërkufitar, mjedisi politik në Shqipëri dhe trendet kryesore të zhvillimit të filantropisë në vend.

Metodologjia e aplikuar në këtë punim konsiston në kërkim dytësor për mbledhjen e informacionit dhe të dhënave bazuar në kuadrin ligjor, rregulloret, vlerësimet e nevojave, studimet e kryera nga OJF-të, donatorët, agjensitë ndërkombëtare dhe kombëtare.

[2] Website Donors and Foundations Networks in Europe. Url: <https://dafne-online.eu/data-and-research/>

Filantropia ka historinë e saj specifike, të lidhur në mënyrë të pandashme me rrethanat sociale, ekonomike dhe historike nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar. Gjurmët e para të filantropisë midis shqiptarëve kanë origjinë shumë të hershme dhe datojnë që nga periudha mesjetare, çka përbën një dëshmi të traditës filantropike të gjatë në Shqipëri. Bamirësia dhe Filantropia u zhvilluan kryesisht nga shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Në fillimet e saj, filantropia u shfaq në fushën e arsimit dhe kulturës, ku u krijua dhe baza për zhvillimin ekonomik të qyteteve shqiptare. Gjatë periudhës komuniste, bamirësia dhe filantropia u zëvendësuan me konceptin e vullnetarizmit dhe solidaritetit. Tranzicioni ekonomik dhe social i Shqipërisë pas viteve 90, i shoqëruar me krijimin e organizatave jofitimprurëse dhe zhvillimin e shoqërisë civile përcaktuan kushtet për rivitalizimin e veprimtarisë bamirëse dhe filantropike në vend (Partnerët Shqipëri, 2011).

Bazuar në monitorimin e përditshëm të aktivitetit filantropik në vend, *mbështetja për grupet e marginalizuara*, e ndjekur nga dhurimi sezonal dhe zbutja e varfërisë janë fushat kryesore të dhurimit gjatë pesë viteve të fundit, 2014 - 2019. *Fëmijët dhe të rinjtë* mbeten përfituesit kryesor të aktivitetit filantropik në mënyrë konsistente.[3] Kur bëhet fjalë për fushat kryesore për të cilat dhuron sektori i biznesit, *zbutja e varfërisë* renditet e para e ndjekur nga arsimit dhe shëndetësia. Kontribuesit më të mëdhenj nga sektori i biznesit i përkasin atij bankar dhe të sigurimeve (Partnerët Shqipëri, 2017).

Gjatë harkut kohor 2015 - 2018, numri i dhurimeve në vit varioi midis 217 dhe 328 duke treguar një trend të qëndrueshëm të dhurimeve. Ka pasur një rritje të jashtëzakonshme në numrin e dhurimeve për vitin 2019 me 90,436 donacione, për shkak të solidaritetit të jashtëzakonshëm të demonstruar në përgjigje të zbutjes së pasojave të lëna nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Përsa i përket natyrës së dhurimit, dhurimi monetar është forma më e zakonshme, e ndjekur nga dhurimet në natyrë. Dhurimet nga sektori i biznesit përbëjnë vlerën më të madhe, veçanërisht për vitin 2017 dhe 2019.[1] Sidoqoftë, këto të dhëna nuk janë shumë të sakta dhe ka arsye për të besuar se vlera e dhurimeve është shumë më e lartë. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave bazohet në raportet e mediave, duke përfshirë mediat sociale dhe burimet e informacionit zyrtar, të vëna në dispozicion nga institucionet publike dhe jopublike. Nuk është e zakonshme që sektori i biznesit, veçanërisht bizneset e vogla dhe të mesme (NVM-të) të raportojnë aktivitetin e tyre filantropik duke qenë se një pjesë e mirë e tyre nuk dëshirojnë të bëjnë publike.

Sipas Partnerëve Shqipëri (2017), aktiviteti filantropik nga sektori i biznesit realizohet kryesisht bazuar në vullnetin e pronarit ose drejtorit ekzekutiv të kompanisë. Vetëm një përqindje e vogël e bizneseve - kryesisht që operojnë në sektorin bankar, të telekomunikacionit, dhe minierave - kanë strategji dhe struktura të posaçme mbi përgjegjësinë sociale të biznesit (PSB). Kryesisht, këto biznese janë tatimpagues të mëdhenj me kapital të huaj, të cilët kanë trashëguar nga kompanitë e tyre mëmë një përgjegjësi të lartë publike të biznesit.

1. SITUATA E SEKTORIT FILANTROPIK NË SHQIPËRI

Edhe pse ekziston një rrjet PSB në Shqipëri nuk ka qenë shumë proaktiv për të promovuar praktikën më të mira ekzistuese, si dhe inkurajimin e bizneseve të tjera për të përfshirë PSB-në si pjesë të strategjive të tyre.

Kryesisht, pronari ose CEO është kontakti i parë për marrjen e kërkesës për dhurim por dhe vendimmarrësi për çdo dhurim, pavarësisht nga madhësia dhe qëllimi. Sidoqoftë, ka disa korporata që kanë filluar të krijojnë fondacionet e tyre filantropike. Duke qenë se filantropia korporative është kryesisht më shumë ad-hoc sesa strategjike, shpesh ka mospërputhje në fushat/çështjet që mbështeten dhe volumin e dhurimeve. Volumi i dhurimeve është i lidhur drejtpërdrejt me performancën financiare të sektorit të biznesit dhe parashikimet optimiste mbi rritjen e tij.

Në kushtet e filantropisë së kryer nga biznesi përmes organizatave jofitimprurëse, sektori i biznesit kërkon që OJF-të të jenë më proaktive duke paraqitur ide apo nevoja sociale që përputhen me strategjinë e biznesit. Një faktor tjetër i rëndësishëm është transparenca e sektorit jofitimprurës dhe impakti i tij në komunitet. Transparenca më e lartë do të rrisë besimin e biznesit për të kanalizuar aktivitetin e tij filantropik përmes OJF-ve (Partnerët Shqipëri, 2017)

Për sa i përket **dhurimit nga individët**, monitorimi i aktivitetit filantropik përgjatë viteve ka treguar që individët përbëjnë një nga donatorët kryesorë në vend. Donatorët individ renditen të parët përsa i përket numrit dhe vlerës së dhurimeve gjatë vitit 2016 dhe 2018.[4] Vihet re se individët janë më të ndjeshëm ndaj shkaqeve si *zbutja e varfërisë* dhe *fatkeqësitë natyrore*. Gjatë viteve të fundit, individët janë përfshirë gjerësisht në fushatat e mbledhjes së fondeve në terren por dhe online duke ofruar dhurime monetare apo në natyrë. Individët kanë treguar një gatishmëri të patëmetë edhe në punë vullnetare dhe shërbime pro-bono. Dhurimi nga individët është ende jo i pasqyruar nga mediat dhe nuk promovohet gjerësisht. Për më shumë se tre vjet, donatorët individ kanë dhuruar në mënyrë aktive në fondacione bamirësie si Fundjavë Ndryshe dhe Fondacioni Firdeus duke treguar një ndjenjë të fortë solidariteti ndaj familjeve të varfëra dhe njerëzve në nevojë.

[3] Për më shumë informacion, të lutem referoju: Monitorimit të Aktivitetit Filantropik në Shqipëri 2015-2020. Url: <http://partnersalbania.org/programs/monitorimi-i-aktivitetit-filantropik-ne-shqiperi/>

[4] Disa shembuj kryesorë të fushatave ku individët kanë treguar një ndjenjë të lartë solidariteti dhe kanë dhuruar masivisht janë: Përmbytjet në Fier në 2015, përmbytjet në Shkodër në 2018, dhe tërmeti i madh i 26 nëntor 2019.

2. KUADRI *TATIMOR* *DHE FISKAL*

2.1. Sistemi Tatimor Mundësues për Marrjen dhe Dhënien e Dhurimeve në Shqipëri

2.1.1. Marrja e Dhurimeve nga Organizatat Filantropike

OF-të nuk kanë asnjë kufizim për të mbledhur fonde nga burime private qoftë lokale ose ndërkombëtare. Grantet, dhurimet, depozitat bankare dhe tarifatat e anëtarësisë përjashtohen nga tatimi mbi fitimin. Nuk ka asnjë kufizim ligjor në lidhje me dhurimet private përveçse i përket volumit, natyrës ose origjinës.

Mallrat dhe shërbimet e ofruara nga OJF-të që janë të lidhura ngushtë me ndihmën dhe kujdesin social; mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, sportin dhe edukimin fizik si dhe mallrat dhe shërbimet për kulturën dhe arsimin janë të përjashtuar nga TVSH-ja.[5]

Në mënyrë që një OF të marrë përjashtimin nga TVSH-ja, duhet të përmbushë këto kritere:

- *Organi vendimmarrës nuk duhet të ketë interes të drejtpërdrejtë në aktivitetin e OF-së;*
- *Aktiviteti jo-ekonomik duhet të mbizotërojë dukshëm nga pjesa tjetër e veprimtarisë së OF-së;*
- *Shërbimet dhe mallrat e prodhuara nga OF-ja nuk duhet të konkurrojnë me sektorin fitimprurës.*
- *Qarkullimi vjetor nga aktiviteti fitimprurës nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave totale vjetore të OF-së.*

Procedura për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së për të gjitha blerjet si pjesë e projektit ka qenë funksionale vetëm për projektet e financuara nga BE-ja, por në praktikë, kjo procedurë nuk ka funksionuar. Procedura është konsideruar mjaft burokratike dhe komplekse; prandaj, asnjë OF nuk ka marrë rimbursim të TVSH-së. Në Dhjetor 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë miratoi një Udhëzim,[6] i cili bën përmirësime të konsiderueshme në drejtim të lëshimit të TVSH-së. Sipas Udhëzimit Nr. 34, "OJF-të të cilat kanë lidhur një kontratë financimi me donatorë gëzojnë të drejtën e rimbursimit të TVSH-së të paguar për blerjen e mallrave dhe shërbimeve". Kjo procedurë shpjegon të gjitha hapat se si do të rimbursohet TVSH-ja për OJF-të dhe nën-grantitë. Tani e tutje, të gjitha fondet e donatorëve (jo vetëm të BE-së) për sektorin jofitimprurës pjesë të marrëveshjeve dypalëshe me qeverinë shqiptare janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

OF-të kanë të drejtë të kryejnë aktivitet ekonomik deri në 20% të të ardhurave totale, nëse aktiviteti ekonomik është në përputhje me misionin parësor të organizatave. Megjithatë, numri i OJF-ve që kryejnë aktivitet ekonomik mbetet i kufizuar. Bazuar në të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave në 2018, 679 organizata jofitimprurëse kryejnë veprimtari ekonomike, ndërsa sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), 319 organizata jofitimprurëse gëzojnë një licencë dhe ofrojnë shërbime sociale dhe edukative (Partnerët Shqipëri, 2019). Shërbimet e ofruara nga OF-të, përveç atyre të përcaktuara në ligj siç u përmend më lart, janë subjekt i TVSH-së. Sidoqoftë, rimbursimi i TVSH-së është praktikisht i pamundur për OF-të për shkak të rregullave që e kushtëzojnë.

2.1.2. Dhurimi nga Biznesi

Ekziston një trend në rritje i aktivitetit filantropik të realizuar në SHBA, Evropë, i reflektuar edhe në mjedisin shqiptar. Kapitali filantropik Evropian është shumë i përqendruar në disa vende, kryesisht si rezultat i fondacioneve shumë të mëdha të korporatave (Observatoire de la Fondation de France, 2015). Edhe në Shqipëri dëshmohet një numër i rritur i bizneseve që kryejnë aktivitet filantropik, nga (62%) në 2011 në (83%) në 2016. Përveçse i përket qendrueshmërisë së aktivitetit filantropik, 40% e bizneseve në Shqipëri që kryejnë aktivitet filantropik shprehen që kanë dhuruar vazhdimisht gjatë harkut kohor 2014 - 2017 (Partnerët Shqipëri, 2017).

Në Shqipëri, dhurimet në formën e sponsorizimit janë lloji i vetëm i dhurimit, i njohur ligjërisht dhe i rregulluar përmes Ligjit për Sponsorizimin.[7] Sistemi tatimor lejon dhurimet ndërmjet 3% dhe 5% (në varësi të llojit të veprimtarive të sponsorizuara) të fitimit përpara tatimit nga subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, duke qenë persona fizikë, juridikë, vendas, të huaj ose ndërmarrje të përbashkëta. Sidoqoftë, lista e aktiviteteve të përjashtuara përfshin vetëm ato humanitare, kulturore, artistike, sportive, arsimore, mjedisore, vepra të letërsisë, shkencës dhe aktivitete kërkimore, duke lënë jashtë demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Dhurimet në natyrë dhe dhuratat e bëra nga bizneset nuk njihen si shpenzime të zbritshme.

[5] Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014 "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i amenduar. Url: <https://www.tatime.gov.al/eng/shkarko.php?id=707>

[6] Udhëzim Nr.34 "Për një Ndryshim të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", datë 05 Dhjetor 2019. Url: https://www.cbc-mne-alb.org/tacka-custom/tacka-media/2019/12/INSTRUCTION-No.34-date_5.12.2019_.pdf

[7] Ligji Nr. 7892/1994 "Për Sponsorizimin", i amenduar, datë 21.12.1994. Url: http://www.vendime.al/wp-content/uploads/2015/08/Ligji_7892_1994_Per_Sponsorizimet.pdf

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka propozuar një ndryshim të ri në Ligjin për Sponsorizim, i cili pritet të miratohet gjatë vitit 2020. Ndryshimi trajton vetëm aktivitetet sportive.[8] Sipas dokumentit:

a) *Për sponsorizime në rastet e ekipeve sportive, njihet zbritja deri në 20 % nga tatimi i fitimit;*

b) *Për sponsorizime për sporte të tjera, njihet tatimi mbi të ardhurat deri në 10%.*

Duke qenë se nuk ka një kuadër ligjor specifik për filantropinë, nuk ka asnjë procedurë të tillë për të raportuar dhurimet si një zë i ndarë veçmas në pasqyrat financiare. Përsa kohë që nuk ka mjete verifikimi do të mungojnë dhe të dhënat e besueshme. Në këto rrethana, shumë biznese nuk i aplikojnë zbritjet tatimore.

2.2. Sistem Tatimor Mundësues për Dhurimet - Praktikë më të mira Ndërkombëtare

2.2.1. Marrja e Dhurimeve nga Organizatat Filantropike

GJERMANIA

Një organizatë jofitimprurëse ndjek qëllime të përgjithshme të përfitimit publik, nëse kërkon të mbështesë publikun “materialisht, intelektualisht ose moralisht”. Lista e aktiviteteve të konsideruara për përfitim të përgjithshëm publik, e cila është ekskluzive që nga viti 2007, përfshin këto kategori: shkencë dhe kërkim, arsim, art dhe kulturë, fe, tolerance ndërkulturore, asistencë për zhvillim, mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, mbështetje për rininë ose të moshuarit, shëndeti publik, sportet amatore, mbështetja e demokracisë, kujdesi për ushtarët dhe rezervistët, dhe mbështetja e angazhimit qytetar. Një organizatë jofitimprurëse konsiderohet se ndjek qëllime “**bamirëse ose dashamirëse**”, nëse mbështet njerëzit në nevojë për shkak të situatës së tyre ekonomike, ose gjendjes së tyre fizike dhe psikologjike.

Statusi i përfitimit publik përcaktohet në **Kodin e Përgjithshëm të Taksave**, ndërsa përfitimet tatimore në lidhje me statusin e përfitimit publik janë adresuar në Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatave, Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat Personale dhe Ligjin për Tatimin mbi Trashëgiminë dhe Dhurimet. Kodi i Taksave parashikon që OJF-të që njihen si organizata me përfitim publik kanë të drejtën e përfitimeve tatimore nëse përfshihen në aktivitete me qëllim “**përfitimin e përgjithshëm publik**”; aktivitete “**bamirëse ose dashamirëse**”; ose aktivitete “**të lidhura me kishën**” (Golubović, 2013).

2.1.3. Dhurimi nga Individët

Në vitin 2018, donatorët individ u renditën të parët në të dhënat që lidhen me numrin dhe vlerën e dhurimeve (Partnerët Shqipëri, 2019). Në Shqipëri, kuadri ligjor nuk e njeh dhurimin nga individët dhe si i tillë, ky lloj dhurimi nuk kualifikohet për marrjen e incentivave fiskale. Një nga faktorët shoqëruar që kontribuojnë në këtë fakt është dhe mungesa e një ligji apo vendimi për deklarimin e të ardhurave personale nga të gjithë individët. Në këtë rast do të bëhej i thjeshtë deklarimi i dhurimeve dhe aplikimi i incentivave tatimore për individët.

Ligji kërkon vetëm për individë me të ardhura mbi 2,000,000 Lekë (15,750 USD), rreth 6% e forcës së punës të paraqesin të ardhurat vjetore personale, gjë që pengon aplikimin e çdo incentive tatimore.

MAQEDONIA

Ligji për Dhurimet dhe Sponsorimin e Aktiviteteve me Përfitim Publik parashikon një sërë rregullash dhe kriteresh që lidhen me dhurimin dhe sponsorizimin, përfshirë incentivat tatimore të parashikuara për donatorët individ dhe bizneset. Shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve kanë të drejtë të marrin dhurime vetëm nëse ato përfshihen në aktivitete me qëllim përfitimin publik.

Ligji veçon aktivitetet me përfitim publik dhe qëllimet e përfitimit publik, edhe pse është e vështirë të kuptohet se cili është dallimi midis këtyre dy termave. Aktivitetet e përfitimit publik konsiderohen aktivitete në fushat vijuese: mbrojtjen e të drejtave të njeriut, arsimin, shkencën, informacionin, kulturën, sportin, mjekësinë, mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e personave me nevoja të veçanta, dhurimin e gjakut, mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen e kafshëve, mbrojtjen e mjedisit, etj. Termi i qëllimeve të përfitimit publik nënkupton mbështetje dhe inkurajim të aktiviteteve në fushat e mëposhtme: mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovimin e kulturës, moralit, arsimit, shkencës, zhvillimin e informacionit dhe shoqërisë bazuar në dije, sport, mbrojtjen e mjedisit, aktivitete socio-humanitare, zhvillimin e shoqërisë civile, promovimin e dhurimit të gjakut, promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe aktivitete të tjera të përcaktuara me ligj në përfitim të publikut (Golubović, 2013).

[8] Draft-Ligji “Për Disa Shtesa dhe Amendime në Ligjin Nr. 7892/1994 “Për Sponsorizimin”, i amenduar. Url: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/256>

2.2.2. Dhurimi nga Biznesi

SPANJA

Spanja është një nga vendet, e cila aplikon incentiva tatimore për individët dhe korporatat që kryejnë aktivitetet filantropik. Sipas Ligjit 49/2002 për “*Tatimin e Entiteve Jofitimprurëse dhe Incentiva Tatimore për Filantropinë*”,^[9] korporatat mund të zbresin 35% të dhurimit. Ka raste që masa e zbritjes mund të rritet edhe me 5% shtesë zbritje si për individët ashtu edhe për korporatat, nëse kontributi për të njëjtën organizatë jofitimprurëse është i qëndrueshëm për të paktën tre vjet (ECNL, 2017).

GJERMANIA

Korporatat janë të perjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave, për aq kohë sa ato dhurojnë për aktivitete me qëllim “përfitimin publik, bamirësinë ose fenë”. Korporatat mund të zbresin deri në 20% të të ardhurave të tyre të tatueshme (bruto) për dhurime. Ekziston një mundësi tjetër, kur korporata mund të zgjedhë të zbresë deri në 0.4% të shumës së kombinuar të pagave dhe xhiros vjetore. Korporatat kanë mundësinë që të mbartin dhurimet për vitet e ardhshme fiskale, të cilat tejkalojnë kufirin e zbritshëm. Pothuajse të gjitha llojet e dhurimeve siç janë dhurimi monetar, në natyrë, pasuritë e paluajtshme njihen (Golubović, 2013).

POLONIA

Korporatat përfitojnë zbritje deri në 10% të të ardhurave të tyre të tatueshme (bruto) për dhurime ndaj organizatave që kryejnë aktivitete me përfitim publik. Shumë lloje dhurimesh njihen duke filluar nga dhurimi monetar, në natyrë, pasuritë e patundshme, letrat me vlerë (Golubović, 2013).

2.2.3. Dhurimi nga Individët

Vendet me dhurimet më të larta individuale krahasimisht me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB-në) në Evropë, janë Mbretëria e Bashkuar dhe Holanda. Duket se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis nivelit të tatimit mbi të ardhurat dhe numrit të dhurimeve nga individët. Prandaj, në shumicën e vendeve ku tatimi është i lartë, përqindja e njerëzve që dhurojnë është më e ulët. Franca, Belgjika dhe Italia, ku të ardhurat nga taksat tejkalojnë 40% të PBB-së, janë të gjitha në gjysmën e poshtme të renditjes (Observatoire de la Fondation de France, 2015).

Vende të tilla si Hungaria, Italia, Moldavia, Polonia, Sllovakia dhe Spanja kanë një mekanizëm të ashtuquajtur “*e drejta e shpërndarjes së taksave*”. Mekanizmi mundëson që individët (gjithashtu dhe korporatat) në Sllovakia të japin një pjesë të pagesës së taksës mbi të ardhurat e tyre për një qëllim specifik ose OJF ashtu siç përcaktohet me ligj.^[10] Fondet e ngritura nga ky mekanizëm nuk janë dhurime, por mbështetje nga buxheti i shtetit.

Mekanizmi është i vlefshëm për disa arsye:

- a) *Kontribuon në forcimin e filantropisë dhe kulturës së solidaritetit;*
- b) *Tregon vlerën e shoqërisë civile;*
- c) *Rrit transparencën, vizibilitetin dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje të OJF-ve;*
- d) *Përmbush boshllëqe të mëdha sa i përket kapacitetit financiar të OJF-ve dhe i bën ata më pak të varur nga fondet e tjera publike;*

Në Hungari dhe Poloni, individët mund të alokojnë 1% të tatimit mbi të ardhurat vjetore tek një grup organizatash, të cilat kanë të drejtë të marrin këtë lloj fondi. Në Poloni, vetëm organizatat me statusin e përfitimit publik kanë të drejtë të përfitojnë nga ky mekanizëm, ndërsa në Hungari statusi i përfitimit publik nuk është një kërkesë, megjithëse organizata përfituese duhet të kryejë aktivitete me qëllim përfitimin publik. Në Rumani, mekanizmi krijon një burim të shtuar të ardhurash për bursat e studentëve bazuar në meritë ose nevoja financiare. Në Lituani, tatimpaguesit mund të shpërndajnë deri në 2% të taksës mbi të ardhurat për artistët (ECNL, 2017).

SLLOVAKIA

Në Sllovakia, ligji parashikon një listë të aktiviteteve që organizatat duhet të kryejnë për t’u kualifikuar si përfitues të mekanizmit “*e drejta e shpërndarjes së taksave*”. Për më tepër, Sllovakia është i vetmi vend në të cilin si individët ashtu edhe personat juridikë lejohen të shpërndajnë një përqindje të caktuar nga taksat e tyre. Individëve u lejohej të alokojnë 2% të tatimit mbi të ardhurat e tyre, ndërsa bizneset mund të alokojnë nga 1.5% në 3% kundrejt një ose më shumë OJF-ve të regjistruara bazuar në preferencën e tyre. Përmes ndryshimeve të miratuara në Sllovakia, individët dhe bizneset tatimpagues mund të zgjedhin të shfaqin identitetin e tyre për organizatat përfituese ose jo. OJF-të duhet të përdorin fondet e marra nga mekanizmi “*e drejta e shpërndarjes së taksave*” deri në një vit e gjysëm nga afati kohor i marrjes së fondeve.

SPANJA

Që nga viti 1988, taksapaguesit spanjollë kanë qenë në gjendje të caktojnë 0.7% të tatimit mbi të ardhurat për qëllime sociale. Ata mund të zgjedhin Kishën Katolike për t’ia alokuar këto fonde ose ti shpërndajnë për “*qëllime të tjera sociale*”. Shpërndarja e fondeve është përgjegjësi e qeverisë, dhe organizatat apo projektet zgjidhen përmes thirrjeve për tender (në varësi të fushës së veprimtarisë) nga institucionet publike kompetente.^[11] Shumica e këtyre fondeve shkojnë në programe që punojnë me të moshuar, fëmijë dhe familje, persona me aftësi të kufizuara, migrantë dhe grupe të tjera të marginalizara (ECNL, 2017).

[9] Ligji Nr. 49/2002 mbi “*Tatimin e Entiteve Jofitimprurëse dhe Incentive Tatimore për Filantropinë*”, 24 Dhjetor 2002. Url: http://noticias.juridicas.com/base_datos/Fiscal/I49-2002.html

[10] Ligjet që specifikojnë mekanizmin “*e të drejtës së shpërndarjes së taksës*” mund të jenë ligje të veçanta, ose të inkuorpuara në ligjin e taksave dhe ligjin e buxhetit vjetor në varësi të shteteve.

[11] Institucionet Publike përgjegjëse në përgjithësi janë Ministri e Shëndetësisë, Politikave Sociale dhe Barazisë, Agjencia Spanjolle për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, ose Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mjedisit.

3.1. Mjedisi Rregullator për dërgimin dhe marrjen e dhurimeve ndërkufitare në Shqipëri

Në Shqipëri, nuk ka asnjë kuadër ligjor që adreson çështjen e dhurimeve ndërkufitare, përveç rregullave përkatës nën rregulloren e pastrimit të parave. Prandaj, dhurimet ndërkufitare qoftë monetare ose në natyrë janë të mundshme përfshirë këtu donatorë individ dhe biznese. Në çdo rast, këto dhurime nuk janë subjekt i ndonjë përjashtimi nga taksat, siç është rasti për dhurimet e bëra nga biznesi brenda vendit që kualifikohen sipas ligjit të Sponsorizimit.

Të gjitha dhurimet hyrëse ndërkufitare (në natyrë), trajtohen si çdo e mirë e importuar. Prandaj ato janë subjekt i TVSH-së dhe detyrimeve doganore përkatëse. OF-të kanë të drejtën dhe lirinë për të marrë donacione nga jashtë, pa miratimin paraprak nga ndonjë institucion publik.

Ligji për Sponsorizimin parashikon zbritjen nga tatimi për kompanitë me kapital shqiptar apo të huaj, por vetëm nëse janë të regjistruara dhe realizojnë dhurime në Shqipëri. Një pengesë këtu është mungesa e pakteve bilaterale për përjashtim nga taksat me shumë vende evropiane.

Projektet ndërkufitare të financuara nga Bashkimi Evropian nuk janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Që nga dhjetori 2019, projektet ndërkufitare gjithashtu kanë të drejtë të marrin rimbursimin e TVSH-së bazuar në procedurën e re të TVSH-së të shpjeguar më lart.

3. AKTIVITETI FILANTROPIK NDËRKUFITAR

3.2. Mjedisi rregullator për dërgimin dhe marrjen e dhurimeve ndërkufitare - Praktikrat më të mira ndërkombëtare

Mjedisi për filantropinë ndërkufitare nuk ka qenë mundësues as brenda vendeve të Bashkimit Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë krijoi një parim të përgjithshëm jodiskriminues, i cili synon të sigurojë lehtësira për organizatat me status të përfitimit publik dhe donatorët kur veprojnë brenda kufijve të BE-së duke aplikuar të njëjtën incentivë tatimore që gëzojnë në vendet e tyre. Mosdiskriminimi i BE-së vlen për një gamë të gjerë fushash nga ekonomia tek të drejtat civile (ECNL, 2017).

Megjithatë, disa vende nuk e zbatojnë parimin dhe vendosin pengesa në shkëmbimin e dhurimeve ndërkufitare. Kjo bëri që Komisioni Evropian të nxjerrë disa procedura shkeljeje kundër Shteteve Anëtare që nuk janë ende në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe lëvizjen e lirë të kapitalit në këtë drejtim. Një nga vendet model është Luksemburgu, i cili zbaton të njëjtin trajtim tatimor ndaj një dhurimi ndërkufitar siç ndodh brenda vendit. Donatorët rezidentë të Luksemburgut duhet të deklarojnë në deklaratën e tyre tatimore se organizata me statusin e përfitimit publik që ka marrë dhurimin e vendosur në një nga shtetet e BE-së, plotëson kërkesat që përmban ligji për tatimin në Luksemburg (European Foundation Centre, 2017).

4.1. Praktika shqiptare

Gjatë viteve të fundit janë krijuar disa struktura dhe mekanizma për dialog dhe bashkëpunim midis OF-ve dhe institucioneve publike në Shqipëri, duke shënuar një përmirësim të dukshëm në vitet e fundit. Ekzistojnë struktura dhe mekanizma për dialog dhe bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, si Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (Partnerët Shqipëri, 2020). Konsultimet publike rregullohen me ligj dhe i detyrojnë autoritetet publike të konsultohen për projektligjet, strategjitë kombëtare dhe lokale si dhe politikat me interes të lartë publik. Çdo institucion publik duhet të emërojë një koordinator për proceset e njoftimit dhe konsultimit publik. Përkundër kësaj, ka akoma institucione publike që nuk kanë arritur ti krijojnë këto struktura. Sektori i OF-ve është duke u bërë një aktor legjitim në zhvillimin e politikave në vend, kjo edhe me mbështetjen e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë që ekzistojnë në lidhje me konsultimin dhe aksesin në informacion.

Burimi kryesor i financimit publik është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e cila nuk përbën një burim të konsiderueshëm financiar për sektorin e shoqërisë civile. Ky institucion shpesh kritikohet për mungesën e përgjegjësisë mbi transparencën dhe rolin e strukturave vendimmarrëse. Ekzistojnë dy skema të tjera në dispozicion, siç është skema e Ministrisë së Kulturës dhe Bordi i Çështjeve të Mira të Lotarisë Kombëtare, por fondet në dispozicion nga këto institucione janë të papërfillshme për nevojat e sektorit. Nuk ekzistojnë kufizime për OF-të të përdorin çdo lloj fondi qoftë kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Po kështu donatorët nuk kanë ndërhyrje nga ndonjë institucion shtetëror në llojin e mbështetjes që ata ofrojnë për sektorin e OF-ve. Sektori mbështetjet shumë në fondet e donatorëve të huaj, ndërsa fondet shtetërore kanë një rol të papërfillshëm në financimin e sektorit.

Së fundmi, ne shohim në Shqipëri forma të reja dhe inovative të filantropisë, njëra prej tyre ishte event i “Rrathë Dhurues” (live crowdfunding) i organizuar nga Partnerët Shqipëri në baza vjetore. Përveç kësaj, ka një rritje në përdorimin e platformave online ndërkombëtare të crowdfunding (kryesisht GoFundMe) nga OF siç është Fundjavë Ndryshe, për fushata të ndryshme që lidhen me fatkeqësitë natyrore siç ishte tërmeti në nëntor 2019, apo çështje që lidhen me fëmijët dhe familjet në nevojë. Fondacioni Firdeus ka një shfaqje televizive të dedikuar për mbledhjen e fondeve, e cila ka përfituar dhurime kryesisht për çështje që lidhen me zbutjen e varfërisë dhe fatkeqësitë natyrore. Nga ana tjetër, Shqipëria nuk është një vend i kualifikuar për të përdorur shumë platforma ndërkombëtare crowdfunding dhe shumica e fushatave për Shqipërinë janë të organizuara nga shqiptarë të diasporës. Për më tepër, Shqipëria (përveç Bosnje Hercegovinës) është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor, i cili nuk ka një platformë lokale crowdfunding (Partnerët Shqipëri, 2019). Zhvillimi i crowdfunding në Shqipëri mund të zgjasë disa vjet për shkak të mungesës së rregullimit ligjor dhe besimit të munguar midis sektorit të biznesit dhe atij jofitimprurës.

4. MJEDISI *POLITIK*

4.2. Praktikë më të mira ndërkombëtare

Disa vende e njohin rëndësinë e filantropisë dhe ngritjes së fondeve dhe dëshmojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për të stimuluar ngritjen e fondeve dhe filantropinë. Një model i suksesshëm është skema e financimit shtetëror në Hungari apo i ashtuquajturit “Fondi i Bashkëpunimit Kombëtar”. Përmes këtij mekanizmi, OJF-të marrin mbështetje nga shteti për të kryer aktivitetet e tyre për ngritjen e fondeve. Ndihma shtetërore nuk tejkalon 5% të të gjitha fondeve të ngritura dhe deklaruar nga organizata aplikante në vitin e kaluar tatimor. Sidoqoftë, mbështetja shtetërore e marrë nga këto organizata është e limituar dhe nuk mund të kalojë afërsisht 1,800 dollarë (ECNL, 2017).

Zhvillimet në sektorin filantropik shoqërohen me përpjekje më të mëdha dhe proaktive nga sektori drejt vetë-rregullimit dhe standardeve më të larta etike, në mënyrë që të ndërtojnë besim dhe legjitimitet për publikun dhe grupet e interesit. Ekzistojnë disa shembuj në lidhje me këtë, njëra prej tyre është **Deklarata Ndërkombëtare e Parimeve Etike në Ngritjen e Fondeve**, e cila përcakton vlerat, besimet dhe parimet që udhëheqin organizatat që ngrenë fonde në të gjithë botën. Standardet e tij të praktikës për ngritjen e fondeve adresojnë pesë fusha kryesore: përgjegjësi ndaj mbështetësve, përgjegjësi për të respektuar legjislacionin/standardet përkatëse, përgjegjësinë ndaj kauzës dhe përfituesve të tyre, menaxhimin, raportimin, kostot e ngritjes së fondeve, pagat dhe shpërblimet (European Fundraising Association, 2018). Sidoqoftë, kjo deklaratë nuk zëvendëson asnjë kod tjetër të etikës që ekziston në vende të ndryshme, por përkundrazi siguron një kuadër global për aktivitetin etik të ngritjes së fondeve.

Ka vende si Britania e Madhe, Irlanda, Franca dhe Spanja, të cilat kanë hartuar nisma vetë-rregulluese për ngritjen e fondeve dhe filantropinë. Në Mbretërinë e Bashkuar, ekziston Kodi i Praktikës së Ngritjes të Fondeve (Civics, 2014), i hartuar nga Instituti i Ngritjes së Fondeve. Kodi i Praktikës së Ngritjes të Fondeve përcakton standardet që zbatohen për ngritjen e fondeve të kryera nga të gjitha institucionet bamirëse dhe palë të treta në Mbretërinë e Bashkuar.[12] Për më tepër, Mbretëria e Bashkuar ka një mekanizëm tjetër siç është “Charity Times Awards”, i cili vlerëson ekselencën në ngritjen e fondeve. Një qasje e ngjashme përdoret nga Irlanda me Kodin e Praktikës dhe Çmimin Kombëtar për Ekselencë duke njohur praktikat më të mira në ngritjen e fondeve (ECNL, 2017).

[12] Website Kodi i Praktikës së Ngritjes së Fondeve. Url: <https://www.fundraisingregulator.org.uk/code>

5. *TRENDET GLOBALE* NË SEKTORIN FILANTROPIK

Evidentohen disa trende në aktivitetin filantropik në Evropë dhe SHBA, pavarësisht ndryshimeve përkatëse që ekzistojnë në të dyja kontinentet.

Në Evropë, numri i donatorëve dhe sasia e dhurimeve vazhdon të rritet, së bashku me nevojën për një transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe nga sektori filantropik. Financimi nga institucionet publike po zvogëlohet dhe organizatat filantropike duhet të diversifikojnë të ardhurat e tyre përmes burimeve të ndryshme (Lilly Family School of Philanthropy, 2018).

Disa mjete novatore duket se janë në qendër të vëmendjes së sektorit, siç janë vullnetarizmi i punonjësve të biznesit, investimet me impakt social, sipërmarrja sociale, crowdfunding, dhurimi online dhe investimi i kapitalit nga bizneset në organizata filantropike apo sipërmarrje sociale. Kuadri Financiar Shumëvjeçar i Bashkimit Evropian 2019 - 2021 pasqyron rëndësinë e filantropisë dhe instrumenteve novatore, të cilat po sjellin zhvillime të shpejta (Lilly Family School of Philanthropy, 2018). Fondacione të tilla si nisma e Fondacionit Gates “Dhurimi nga të Gjithë” ka financuar dizajne eksperimentale, aplikacione të reja, platforma dhurimi, dhe hulumtim të eventeve crowdfunding si rathë dhurues (Bernholz, 2020).

Alternativa të tilla si *filantropia e mbështetur në besim* dhe *grantdhënia me pjesëmarrëse* po ndryshojnë shumë dinamikën në marrëdhëniet midis donatorëve dhe organizatave jofitimprurëse (grantmarrësve). Filantropia e mbështetur në besim bazohet në vlera të tilla si ndarja e pushtetit, barazia, transparenca, partneriteti përtej financimit dhe bashkëpunimit që inkurajojnë fonde të pakushtëzuara, duke bërë përpjekje shtesë që donatorët të përputhen me misionin dhe vlerat e organizatave jofitimprurëse, dhe jo qasjen tradicionale (ku sektori jofitimprurës duhet të përafrohet me vlerat e donatorëve) (Whitman Institute, 2019). Ndërsa, grantdhënia me pjesëmarrje lidhet me “zhvendosjen e pushtetit vendimmarrës për financimin (përfshirë strategjinë dhe kriteret) nga financuesit të komunitetit ku iu shërbejnë” (Gibson, 2017, p. 7).

Fondacionet Komunitare, si institucione jofitimprurëse që mobilizojnë dhe investojnë burime njerëzore dhe financiare në një zonë specifike gjeografike po rriten me shpejtësi si model në Evropë.[13] Ky është një model, i cili po funksionon si një ndërmjetës për ta bërë dhurimin më efektiv duke bashkuar forcat dhe reduktuar kostot administrative. Ndërsa filantropia dhe komunitetet kanë investuar për një rritje gjithëpërfshirëse për më shumë se një dekadë, fokusi tashmë është vendosur tek krijimi i një partneriteti midis sektorit privat dhe atij jofitimprurës (Johnson Center for Philanthropy at Grand Valley State University, 2020).

Pavarësisht zhvillimeve, në shumë vende evropiane vihet re mungesa e institucioneve të specializuara kërkimore dhe një metodologji e përbashkët për monitorimin e aktivitetit filantropik. Si rezultat, Evropa ka mbetur prapa si rajon në publikimin e të dhënave të besueshme dhe të përditësuara mbi aktivitetin filantropik. Duke qenë se përbën sfidë mbledhja dhe analiza e të dhënave filantropike në këtë rajon, ka përpjekje nga disa organizata filantropike Evropiane për adresimin e kësaj çështjeje bashkarisht. Kjo do të jetë e dobishme për praktikuesit, politikëbërësit dhe studiuesit e fushës për të kuptuar më mirë impaktin e sektorit dhe për të legjitimuar përpjekjet në iniciativat advokuese të bazuara në fakte.[2]

Filantropia dhe teknologjia po ndryshojnë me shpejtësi, veçanërisht në SHBA. Ekspertët vlerësojnë se më shumë se 150 trilion gigabajt të dhëna do të duhet të analizohen deri në vitin 2025 (Kulkarni, 2019). Termi “të dhëna mbi filantropinë”[14] është relativisht i ri, sepse u prezantua nga Kombet e Bashkuara në vitin 2011. Edhe pse burimet kanë qenë të kufizuara, filantropët dhe fondacionet më të mëdha po i investojnë burimet e tyre në shkencëtarë dhe analistë të dhënash në këtë drejtim si dhe në mbështetjen e organizatave jofitimprurëse. Institucionet kanë inkurajuar një formë të re partneriteti, në të cilën bizneset do të ndajnë të dhëna për informim publik (Kirkpatrick, 2011).

Në Shtetet e Bashkuara dhe disa vende të Evropës Perëndimore, ka shumë donatorë individ dhe fondacione të krijuara nga familje të pasura. Këto fondacione janë gjithnjë e më shumë të prirura për të ofruar mbështetje institucionale sesa çështje në sektorë të ndryshëm (Johnson Center for Philanthropy at Grand Valley State University, 2020, p. 10).

Shumë fondacione private, të cilat marrin grante nga donatorë ndërkombëtarë, kanë punuar me OZHQ (17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm). OZHQ-të po tërheqin vëmendjen e fondacioneve komunitare, të cilat po bëjnë përpjekje të konsiderueshme për t'i mishëruar këto objektiva si pjesë të vlerave të tyre (Ross, 2018). Situata pandemike e Covid 19 gjithashtu do të ndikojë në mjedisin filantropik dhe do të tërheqë vëmendjen e investimeve drejt infrastrukturës mjekësore dhe kërkimeve në këtë fushë.

Ndryshimet dinamike në mjedisin filantropik i kanë dhënë një rëndësi të veçantë Përgjegjësisë Sociale të Biznesit (PSB-së). PSB si një term gjithëpërfshirës kërkon të realizojë një përputhje të veprimtarisë filantropike me objektivat e biznesit. Së fundmi, PSB nuk është një domen vetëm i korporatave të mëdha, sepse ndërmarrjet e vogla dhe të mesme po përqafojnë strategji në fushën e PSB-së duke u angazhuar gjithnjë e më shumë në mënyrë strategjike (Johnson Center for Philanthropy at Grand Valley State University, 2020).

[13] Website i European Community Foundation Initiative. Url: <https://www.communityfoundations.eu/community-foundations-in-europe/knowledge-centre.html>

[14] Të dhëna mbi Filantropinë – një term i cili përshkruan një formë të re partneriteti ku sektori i biznesit duhet të ndajë të dhëna për përfitim publik.

Përtej të gjitha përpjekjeve kryesore për të fuqizuar filantropinë, ekziston një valë në rritje e kritikëve për filantropinë e realizuar nga korporatat e mëdha. Disa madje dyshojnë se korporatat e mëdha pas aktivitetit filantropik fshehin aktivitete të “pastrimit të parave” apo dëshirojnë të pastrojnë imazhin e tyre. Kjo e vendos sektorin jofitimprurës në një pozicion të vështirë dhe ka nevojë për një rritje të ndërgjegjësimit të këtij sektori për të krijuar politika, procedura ose kode etike me qëllim realizimin e një vetingu të kujdesshëm të donatorëve përpara se të pranojnë dhurime (Rendon, 2019). Disa kritikë kalojnë shumë shpejt nga shqetësimi për filantropinë më elitare dhe joetike në dënimin e gjithë praktikës së filantropisë. Edhe pse kritikët janë të rëndësishëm për të mbajtur përgjegjës donatorët e mëdhenj në shoqëri, ekziston një kërcënim i madh për të minuar rolin e rëndësishëm të filantropisë në shoqëritë demokratike (Buchanan, 2019).

Duke ndjekur trendet globale, Shqipëria ka rritur përpjekjet drejt zhvillimit të mjeteve dhe mekanizmave filantropik. Nisma të ndryshme të ndërmarra nga organizata ndërmjetëse siç janë Partnerët Shqipëri për të rritur urat e bashkëpunimit midis biznesit dhe OJF-ve përmes takimeve formale dhe joformale ka kontribuar në një partneritet strategjik më të mirë midis sektorëve. Duke marrë parasysh që sektori privat pret një transparencë më të madhe nga sektori i OF-ve, një iniciativë e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri tenton ta zbusë këtë sfidë përmes zhvillimit të një Kodi Standartesh për sektorin. Ato organizata që do të zbatojnë parimet e Kodit të Standarteve pritet të jenë më të avantazuara për të marrë fonde nga sektori i biznesit për shkak të rritjes së transparencës. Edhe pse në një fazë fillestare, ekzistojnë disa gjurmë të formave novatore të filantropisë në Shqipëri siç janë rrathët dhurues dhe dhënia e granteve ndaj sipërmarrjeve sociale nga sektori i biznesit.

Disa katastrofa që po ndodhin në fund të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020 si tërmetet dhe situata e pandemisë (COVID 19) do të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe më gjerë. Pra, mbetet për t'u parë madhësia e ndikimit në këtë sektor dhe aspektet që do të preken. Gjithashtu i mbetet së ardhmes analiza sesi do të ndikojë kjo krizë globale në ndryshimin e misionit dhe aktivitetit të këtyre organizatave.

6. *REKOMANDIMET KRYESORE* PËR PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT FILANTROPIK

Krijimi i një mjedisi mundësues për sektorin e biznesit dhe individët për kryerjen e aktivitetit filantropik

Kuadri ligjor për rregullimin e aktivitetit filantropik është i nevojshëm për ta njohur filantropinë si një aktivitet të ndarë nga sponsorizimi. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të vendosen incentiva fiskale për biznesin dhe të njihet dhurimi nga individët. Në nivel praktik, është thelbësore të hartohen procedura të lehta dhe transparente për bërjen dhe marrjen e dhurimeve. Kjo do të lehtësojë barrierat për kryerjen e aktivitetit filantropik si dhe do të rrisë transparencën dhe mbledhjen e të dhënave në këtë fushë.

Zhvillimi i strategjive të qëndrueshme të PSB-së si pjesë thelbësore e sektorit të biznesit

Kompanitë duhet të investojnë në njohuri dhe fonde të dedikuara për të fuqizuar strukturat dhe strategjitë e tyre të PSB-së. Rrjeti i PSB-së duhet të promovojë praktikën e mira ekzistuese dhe të inkurajojë kompanitë e tjera që të zhvillojnë strategjitë e PSB-së në përputhje me qëllimin e tyre ekonomik. Rrjeti i PSB-së duhet të jetë më proaktiv për të mundësuar programe shkëmbimi për bizneset shqiptare, të cilat mund të përfitojnë nga praktikën më të mira në rajon dhe më gjerë. Strategjitë e publikuara mbi PSB-në dhe filantropinë korporative nga bizneset, do të ndihmojnë OF-të të krijojnë partneritet me këtë sektor në fusha interesi të përbashkëta.

Ndërtimi i urave të partneritetit midis OF-ve dhe sektorit të biznesit

OF-të janë një partner i rëndësishëm që mund ti vijë në ndihmë sektorit të biznesit për të realizuar detyrimin e tij moral ndaj klientëve dhe komunitetit në përgjithësi. OF-të duhet të jenë proaktive për të krijuar një marrëdhënie besimi me sektorin e biznesit. Para krijimit të kontakteve të para me biznesin, OF-të duhet të hulumtojnë më shumë mbi vlerat, interesat dhe fushat e përgjegjësisë sociale të secilit biznes me të cilin ato kërkojnë të bashkëpunojnë. Përmirësimi i transparencës dhe standardeve do t'i bëjë OF-të partnerë të besueshëm për të kanalizuar dhurimet e biznesit, por dhe për të hartuar programet e filantropisë bashkarisht.

Përdorimi i mjeteve online dhe inovative

Duhet të zhvillohen mënyra të reja të ndërveprimit dhe ngritjes së fondeve, siç janë platformat online crowdfunding, investimi në projekte me impakt social, etj., të cilat pothuajse mungojnë në Shqipëri. Sektori i OF-ve duhet të investojë më shumë në këto mjete alternative, si një mënyrë për të rritur kapacitetin financiar dhe për të përmbushur misionin e tyre kundrejt përfituesve. Nëse sektori jofitimprurës ndërton një reputacion më të besueshëm dhe marrëdhënie transparente me sektorin publik dhe biznesin, përdorimi i këtyre mjeteve për ngritjen e fondeve do të ishte më efektiv.

Investimi në kërkim shkencor dhe të dhëna për filantropinë

Ka pak të dhëna mbi volumin real të filantropisë dhe impaktin e saj social në Shqipëri. Disponimi i të dhënave të besueshme do të krijojë përfitime në shumë drejtime duke filluar nga mbështetja e përpjekjeve advokuese të sektorit jofitimprurës, në informimin e ndryshimeve ligjore, edukimin dhe kërkimin shkencor. Universitetet, qendrat kërkimore, dhe OF-të duhet të përfshihen në mbledhjen e të dhënave, analiza dhe hulumtime të cilat do të kontribuojnë në kuptimin më të mirë të impaktit që krijon sektori filantropik.

REFERENCA

Bernholz, L. (2020). *Philanthropy and Digital Civil Society: Blueprint 2020*. Stanford University's Center on Philanthropy and Civil Society. Retrieved from <https://pacscenter.stanford.edu/wp-content/uploads/2019/12/Blueprint-2020-FINAL-DIGITAL.pdf>

Buchanan, P. (2019). *Giving done right: effective philanthropy and making every dollar count*. New York: Public Affairs.

Charities Aid Foundation. (2019). *CAF World Giving Index*. Retrieved from https://www.cafonline.org/docs/default-source/about-us-publications/caf_wgi2018_report_webnopw_2379a_261018.pdf?sfvrsn=c28e9140_4

Civicus. (2014). *Accountability for Civil Society by Civil Society: A Guide to Self-Regulation Initiatives*. Retrieved from <https://www.civicus.org/images/stories/CIVICUS%20Self-regulation%20Guide%20Eng%202014.pdf>

Council on Foundations. (n.d.). What are some different kinds of private foundations? Retrieved from <http://www.cof.org/content/foundation-basics>

ECNL. (2017). *The Regulatory Framework for Fundraising in Europe*. Retrieved from http://ecnl.org/wp-content/uploads/2017/11/The-Regulatory-Framework-for-Fundraising-in-Europe_ECNL-research.pdf

European Commission. (2002). Corporate Social Responsibility Main issues. Brussels. Retrieved from http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-02-153_en.htm

European Foundation Centre. (2015). *Comparative Highlights of Foundation Laws: The Operating Environment for Foundations in Europe*. Brussels. Retrieved from <https://www.issuelab.org/resource/comparative-highlights-of-foundation-laws-the-operating-environment-for-foundations-in-europe-2015.html>

European Foundation Centre. (2017). *Boosting cross-border philanthropy in Europe*. Retrieved from <https://www.efc.be/uploads/2019/03/Boosting-Cross-Border-Philanthropy-in-Europe-Towards-a-Tax-Effective-Environment.pdf>

European Fundraising Association. (2018). *International Statement of Ethical Principles in Fundraising*. Retrieved from <https://efa-net.eu/wp-content/uploads/2018/10/international-statement-of-ethical-principles-in-fundraising-july-2018.pdf>

European Research Network on Philanthropy. (2017). *Giving in Europe - The state of research on Giving in 20 European Countries*. Amsterdam: Lenthe Publishers. Retrieved from <http://ernop.eu/wp-content/uploads/2017/05/Giving-in-Europe-Executive-Summary-WEBSITE.pdf>

Gibson, C. (2017, October). *Participatory Grantmaking: Has its time come?* Retrieved from Ford Foundation: https://www.fordfoundation.org/media/3599/participatory_grantmaking-lmv7.pdf

Golubović, D. (2013). *Tax Laws Affecting Philanthropy in the Countries of South Europe*. Belgrade.

Johnson, P. (2018). *Global Philanthropy Report: Perspectives on the global foundation sector*. Harvard Kennedy School.

Johson Center for Philanthropy at Grand Valley State University. (2020). *11 Trends in Philanthropy for 2020*.

Kirkpatrick, R. (2011, September). *Data philanthropy: Public & private sector data sharing for global resilience*. Retrieved from <https://www.unglobalpulse.org/blog/dataphilanthropy-public-private-sector-data-sharing-global-resilience>

Kulkarni, R. (2019). *Big data goes big*. Retrieved from Forbes: <https://www.forbes.com/sites/>

Liang, H., & Renneboog, L. (2016). Corporate Donations and Shareholder Value. *European Corporate Governance Institute - Finance Working Paper No. 491/2016*.

Lilly Family School of Philanthropy. (2018). *The Global Philanthropy Environment Index 2018*. Indiana University. Retrieved from <https://dafne-online.eu/wp-content/uploads/2019/05/gpei18-europe.pdf>

Observatoire de la Fondation de France. (2015). *An overview of philanthropy in Europe*. Retrieved from <http://efc.issuelab.org/resource/an-overview-of-philanthropy-in-europe.html>

Partners Albania. (2011). *A historical View of the Development of Philanthropy in Albania*. Retrieved from https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2016/01/A_Historical_View_of_the_Development_of_Philanthropy_in_Albania.pdf

Partners Albania. (2017). *Philanthropic activity of enterprises in Albania*. Retrieved from <http://partnersalbania.org/publication/philanthropic-activity-of-enterprises-in-albania-second-survey-2016/>

Partners Albania. (2019). *Crowdfunding Platforms: An Alternative Source of Funding*. Retrieved from https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/05/Crowdfunding_platforms_an_alternative_source_of_funding.pdf

Partners Albania. (2019). *Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development, Country Report for Albania 2018*. Retrieved from <http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Monitoring-Matrix-Country-Report-for-Albania-2018.pdf>

Partners Albania. (2019). *Overview of Social Enterprises Eco-system in Albania*. Retrieved from <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/04/Overview-of-Social-Enterprises-Eco-system-in-Albania.pdf>

Partners Albania. (2020). *Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development, Country Report for Albania 2019*.

Rendon, J. (2019, September 19). How to protect your nonprofit from controversial donors. *Chronicle of Philanthropy*. Retrieved from <https://www.philanthropy.com/article/How-to-Protect-YourNonprofit/247176>

Ross, N. (2018). *Local leadership, global impact*. Council on Foundations. Retrieved from <https://www.cof.org/sites/default/files/documents/files/local-leadership-global-impact.pdf>

USAID. (2019). *2018 CSO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Eurasia*. Retrieved from https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1866/CSOSI_Report_7-28-17.pdf

Whitman Institute. (2019). *Trust-based Philanthropy*. Retrieved from Whitman Institute: <https://thewhitmaninstitute.org/grantmaking/trust-based-philanthropy/>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

www.partnersalbania.org